

THIRRJE PËR APLIKIM NË SHKOLLËN POLITIKE TË LËVIZJES BESA

Lëvizja BESA shpall thirrjen për aplikim për pjesëmarrje në Shkollën Politike, një program i dedikuar për të rinjtë dhe aktivistët që synojnë të thellojnë njohuritë e tyre mbi teorinë politike, historinë politike në Maqedoni, gjeopolitikën, administrimin publik, komunikimin publik dhe shumë çështje të tjera që lidhen me politikën.

Çfarë ofron Shkolla Politike?

- Leksione nga ekspertë të politikës, akademikë dhe figura publike;
- Seminare interaktive dhe diskutime mbi sistemin politik dhe zgjedhor në Maqedoninë e Veriut;
- Trajnime praktike mbi shkrimin e deklaratave politike, paraqitjen publike dhe strategjitë politike;
- Rrjetëzim me individë të angazhuar në sferën publike dhe politike.

Kush mund të aplikojë?

- Të rinjtë e moshës 18-30 vjeç që janë të interesuar për politikën dhe aktivizmin shoqëror;
- Studentë, aktivistë dhe profesionistë të rinj që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe politike;

Si të aplikoni? Për të aplikuar, ju lutemi të plotësoni formularin e aplikimit në linkun e mëposhtëm:

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfm-hT8KTgdq4OSXKmGSqz8HXXJ5kUIZTE35Ijt8_Bg6wSyQ/viewform?usp=dialog



Afati i aplikimit: Deri më 31 Mars 2025



Për më shumë informata, na kontaktoni në: cabinet@levizjabesa.mk

Mos e humbni mundësinë për të qenë pjesë e një platforme që formon liderët e së nesërme! Aplikoni tani!